



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:037881

Datë: 09.07.2019

Numri i dokumentit: 00401465

**P.nr.321/2018**

### **NË EMER TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA NË SUHAREKË**, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lëndën penale sipas P.Th. nga Prizreni, aktakuzës PP/II.nr.1109-2/17 të datës 17.07.2017, ndaj të akuzuarve A.T nga fshati Q.Komuna Suharekë dhe F.G nga fshati D. Komuna Suhareke, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 i Kodit Penal, në prezencë të prokurorit të PTH-së, nga Prizreni Atnor Skoro dhe të akuzuarve, në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me dt.01.07.2019, mori, publikisht shpalli dhe me date 09.07.2019 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

1. I akuzuari A.T i lindur më 06.11.1976, me numër 1016290285, i biri i E.T dhe nënës R.S me vendbanim në fshatin Q.komuna Suharekë,i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i R. se Kosovës,
2. E akuzuara F.G i lindur më 17.06.1974, me numër 1002954202, e bija e R.G dhe nënës F.G me vendbanim në fshatin Q.Komuna Suharekë, e gjendjes së dobët ekonomike, e martuar, nene e tre fëmijëve, shqiptare shtetase e R. se Kosovës.

### **JANË FAJTOR**

Sepse me date 11.03.2017 ne ore të pa vërtetuar, në Suhareke, në Qendrën Tregtare "ETC" në bashkëveprim, personit tjetër i a marrin pasurinë me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër, në atë mënyrë që shkojnë në qendrën tregtare të lartë cekur, shfrytëzojnë momentin e volitshëm dhe nga aty marrin 2(dy) parfume për automjete, 1 (një) pale dëgjuese të telefonave, 1 (një) top për fëmije, dhe largohen nga vendi i ngjarjes, me ç, rast të dëmtuarës – Qendrës tregtare "ETC", i shkaktojnë dem material.

**Me këtë kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 51, 52, 73, 74 KP si dhe 359 par. 1 dhe 2 dhe neni 365 KPP-së, i u shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT**

**Të akuzuarit, A.T**

Duke i vërtetur dënimin me burgim prej 2 (dy) muajve, si dhe dënim me gjobe në shume prej 100 (njqinde) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse në afatin e verifikimit prej një viti i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**Të akuzuarës, F.G**

Duke i vërtetur dënimin me burgim prej 2 (dy) muajve, si dhe dënim me gjobe ne shume prej 100 (njeqinde) euro, te cilat dënime nuk do te ekzekutohen në afatin e verifikimit prej një viti nëse e akuzuara nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit lirohen nga shpenzimet e procedurës konform nenit 453 par. 4 te KPP-ës. Udhëzohet pala e dëmtuar; Q.T “ETC”, me seli ne Suharekë, qe kërkesën pasurore juridike ta realizoj ne kontest te rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

PTH-e me aktakuze, ka akuzuar A.T nga fshati Q.Komuna Suharekë dhe F.G nga fshati D.Komuna Suhareke, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale vjedhja nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal, te cilin gjatë seancës se shqyrtimit fillestare e ka përfaqësuar PSH nga Prizreni Atnor Skoro, i cili ne tërësi ngel pranë te dhënave si ne aktakuze, qe të akuzuarit të shpallen fajtor dhe te dënohen sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarve ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarve të cilët ne shqyrtimin fillestar e knëa pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-së ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarve, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarve nga ana e PTH-së ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestare nga ana e te akuzuarit, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale tregti e ndaluar nga neni 305 par. 1 i Kodit Penal, andaj Gjykata ka vendosur se të akuzuarit janë fajtor dhe iu shqiptoj dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-ës, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se të akuzuarit kanë pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, kanë bere pranimin e fajësisë ne mënyrë vullnetare, janë penduar për veprën e kryer, është hera e pare qe bie ndesh me ligjin, kurse rrethana posaçërisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-së. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori ne kuptim te nenit 452 par, 1 te KPP-së.

### **GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE**

**G j y q t a r i**  
**Qemail Suka**

**KESHILLE JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.